

SHKOLLA FILLORE KOMUNALE

“ IBE PALIKUQA “

BOJANË

KOMUNA E SARAJIT



**PROGRAMI VJETOR**  
**PËR PUNËN E SHKOLLËS NË VITIN SHKOLLOR**  
**2024/ 2025**

Gusht – 2024

## PËRMBAJTJA

1. Pjesa hyrëse
2. Letër njoftimi i shkollës
  - Zhvillimi i mesit lokal dhe regjional dhe historiat i shkollës
  - Profilet kadrovike dhe zhvillimi i shkollës
  - Kushtet për punë dhe vendosja territoriale-organizative
  - Të dhënat e përgjithshme të shkollave
  - Kushtet hapësirore për punën e shkollave
  - Kushtet materiale-teknike
  - Harta e shkollës ( ku ndodhet ), plani i hapësirave
  - Struktura e shkollës
  - Shkalla e arsimimit të të punësuarve
  - Struktura e moshave të të punësuarve
  - Nxënësit (tabela unifikuese, numri i nxënësve, struktura e nxënësve.)
  - Gjuha mësimore
3. Misioni dhe vizioni i shkollës
4. “Lessons Learned” – E mësuar/Përvoja të fituara
5. Fusha e ndryshimeve, prioriteteve dhe qëllimeve
  - Integrimi ndëretnik në arsim
  - Integrimi i edukatës ekologjike në procesin edukativo-arsimor
6. Planet aksionare
7. Plan për evaulimin e planeve aksionare
8. Kalendar i vjetor i shkollës
9. Mësimi dhe realizimi mësimor
  - Pasqyrë e lokaleve në të cilat realizohet mësimi dhe lokalet tjera
  - Lokalet për veprimtari shoqërore dhe pedagogjike
  - Pasqyra e personelit udhëheqës, pedagogjik, administrativ dhe teknik për vitin shkollor 2023/2024
  - Mbjtësit e higjienës
  - Lëndët e obliguara dhe zgjedhore
  - Mësimi plotësues dhe shtues
  - Programe të individualizuara për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore
  - Bashkimi i programit ekologjik me mësimin e rregullt
  - Shfrytëzimi i TIK në procesin mësimorë
  - Planifikimi i orarit të punës në SH.F.K”Ibe Palikuqa”-f.Bojanë
  - Pasqyra e kuadrit arsimor për vitin shkollor 2023-2024
10. Vlerësimi
  - Vetevalumi i shkollës
11. Aktivitetet jashta-mësimore
  - Aktivitetet gjatë vitit shkollor

- Organizata e Kryqit të kuq
  - Aktivitetet e lira të nxënësve
  - Aktivitetet artistiko-kulturore
  - Aktivitetet sportive
12. Përkrahja e nxënësve
- Programi preventiv kundër dhunës
  - Programi parandalues kundër sëmundjeve të varësive
  - Siguria në shkollë
  - Klima pozitive socio – emocionale
13. Kujdesi për shëndetin
- Higjiena në shkollë
  - Kontrollimet sistematike
  - Vaksinimi
  - Edukimi për ushqim të shëndoshë
14. Klima në shkollë dhe raportet në shkollë
- Disiplina
  - Rregullimi estetik dhe funksional i hapësirës në shkollë
  - Kodi etik
  - Multi-kulturalizmi
  - Raporte në mes të gjitha strukturave
15. Zhvillimi profesional i kuadrit arsimor
- Detektimi i nevojave dhe prioriteteve
  - Aktivitete për zhvillim profesional
  - Zhvillimi personal profesional
  - Mësimi horizontal
  - Organet profesionale në shkollë, planet për punën e tyre
  - Plani për punën e Këshillit të klasave
  - Plani për punën e aktiveve profesionale
16. Kyqja e familjeve në shkollë
- Shqyrtimi i suksesit, sjelljes dhe rregullsisë së nxënësve
  - Sigurimi i shkollës dhe nxënësve
  - Aktivitete nga jeta kulturore argëtuese e nxënësve
  - Përkrahja financiare dhe donacionet
  - Bashkëpunimet dhe aktivitetet tjera
17. Komunikimi me publikun dhe promovimi i shkollës
- Bashkësia lokale
  - Institucione nga fusha e kulturës
  - Institucionet nga fusha e arsimit
  - Organizatat joqeveritare
  - Organizatat shëndetësore
  - Mediumet

## **PJESA HYRËSE**

Programi vjetor për punën e shkollës është punuar dhe përpiluar në bazë të Nenit 30 të Ligjit për arsim fillor të Republikës së Maqedonisë Veriore të shpallur në ( Gazeta Zyrtare të R.M.V. nr.161/19 dhe 229/20).

Dokumentet mbi të cilat bazohet Programi vjetor:

- Nën-ligjet dhe aktet interne ( Statusi i shkollës, Kodeksi etik dhe Rregulloret).
- Plan-programet mësimore
- Koncepti për arsimin fillor nëntëvjeçar
- Programi zhvillimor i shkollës
- Programi për punën e shkollës nga viti i kaluar
- Raportet ( raporti vjetor i shkollës nga viti i kaluar, raportet nga evaulimi integral, raporti nga vetevaulimi, raporti nga vlerësimi ekstern, raportet për punën financiare të shkollës).

Me propozimin e Kolegiumit arsimor, Këshilli i shkollës e aprovoi këtë program në mbledhjen e mbajtur më 12.08.2024.

### **2. Letërnjoftimi i shkollës**

Në përgatitjen e planit vjetor të Shkollës Filllore komunale “IBE PALIKUQA” në fshatin Bojanë për vitin shkollor 2024/25 janë shfrytëzuar dokumente dhe përvoja relevante siç janë: Koncepti për edukim dhe arsim fillor nëntëvjeçar i Byrosë për zhillim të arsimit, struktura e përgjithshme programore ligjore, përcaktimet ligjore të ligjit për arsim fillor, koncepti i planit arsimor dhe Udhëzimet e aprovuara nga Byroja për zhvilimin e arsimit, Raporti për punën e shkollës gjatë vitit shkollor 2023/2024, të dhënat e dorëzuara në Byronë për zhvillim të arsimit dhe në Ministrinë e arsimit dhe shkencës, gjatë vitit të kaluar shkollor si dhe procesverbalet e pranuar nga organet dhe organet profesionale, etj.

Në punimin dhe përgatitjen e Programit vjetor të shkollës për vitin shkollor 2024/25 kanë marrë pjesë : drejtori i shkollës, shërbimi pedagogjik dhe kryetari i Këshillit të shkollës si dhe bashkëpunëtorë tjerë. Punimi dhe përpilimi i këtij Programi vjetor filloi pas mbajtjes së Kolegiumit arsimor, të datës 12.08.2024 në të cilën mbledhje u bë sistemimi i ri i arsimtarëve të mësimit klasor dhe lëndor dhe shpërndarjes së orëve mësimore. Të gjitha konkluzat dhe konstatimet që dolën nga kjo mbledhje janë përfshirë në këtë program.

Në mbledhjen e Kolegiumit arsimor poashtu u vendos që deri më 06.09.2024 arsimtarët t'i dorëzojnë plan-programet e tyre vjetore te shërbimi pedagogjik, ndërsa deri me 13.09.2024 të dorëzohen te i njëjti shërbim edhe planet për aktivitetet tjera. Në të njëjtën mbledhje u përkujtuan

të gjithë arsimtarët se janë të obliguar të kenë të përgaditura skenar të orës për realizimi e procesit edukativo-arsimorë.

## **ZHVILLIMI I MESIT LOKAL DHE REGJIONAL DHE HISTORIATI I SHKOLLËS**

Shkolla fillore komunale “ IBE PALIKUQA “është e vendosur në fshatin Bojanë. Fshati Bojanë shtrihet në Veri-perendim të shkupit në largësi prej 23,4 km në rrugën Shkup -Tetovë. Vendi është i njohur për kultivimin e vreshtave. Fshati i takon Komunës së Sarajit, respektivisht trevës së Dervenit.Për nga karakteri ekonomik ky lokacion është më tepër bujqësor. Në afërsi të fshatit Bojanë gjendet edhe fshati Llaskarcë i cili poashtu ka karakter të zhvillimit ekonomik bujqësor . Edhe fshati i tretë Paniçarë që bën pjesë në këtë lokacion, është fshat më kodrinoro-malor dhe ka karakter bujqësoro-blegtoral. Përndryshe i tërë ky territor ku shtrihen shkolla qendrore në fshatin Bojanë dhe dy shkollat periferike në përbërje të saj, në fshatin Llaskarcë dhe Paniçarë, nuk është ekonomikisht aq i zhvilluar, nuk ka objekte të rëndësishme industrialo-ekonomike. Popullata, respektivisht prindët e nxënësve pjesërisht merren me bujqësi dhe një pjesë e tyre janë të punësuar nëpër organizata e ndërmarrje të ndryshme, por ka mjaft prind që nuk janë të punësuar dhe përbëjnë grupin e të rrezikuarve social. Përndryshe ky regjion i Komunës së Sarajit ka një zhvillim relativisht mesatar ekonomik.

Duke u nisur nga performancat natyrore që i posedon ky rajon, e në veçanti fshatrat ku gjendet shkolla fillore komunale “ IBE PALIKUQA “si dhe me themelimin e Komunës së Sarajit, ligjit të ri për decentralizim dhe iniciativat e ndryshme, krijohen mundësi reale dhe optimale për zhvillimin dhe përparimin e përgjithshëm ekonomik, kulturor, arsimor, shëndetësor, etj. Në këtë mjedis me perspektivë, arsimit zhvillohet vetëm në kuadër të shkollës fillore komunale “ IBE PALIKUQA “ në fshatin Bojanë dhe dy shkollat periferike në fshatin Llaskarcë dhe Paniçarë. Këto tre shkolla janë të themeluara në vitin 1945, si shkolla fillore katërvjeçare, Prej vitit 1967 në Bojanë hapet shkolla tetëvjeçre, në vitin 1970 edhe shkolla periferike e Llaskarc dhe Paniçarë shëndërohen në tetëvjeçare. Që prej themelimit të tyre e deri më sot, një periudhë si të veçanta e mandej edhe të integruara në një shkollë qendrore, këto objekte edukativo-arsimore në çdo aspekt kanë shënuar një zhvillim permanent në edukimin dhe arsimimin e brezit të ri. Krahas rritjes së numrit të nxënësve,si rezultat edhe i rritjes së numrit të popullatës, janë zgjeruar edhe lokalet e shkollave.

Shkolla fillore në Bojanë,Saraj-Shkup, është ndërtuar në vitin 1935, me material të dobët, në vitin 1967 janë ndërtuar tre klasë të reja. Shkolla disponon me nëntë klasë të cilat disa nuk i plotësojnë normat pedagogjike për zhvillimin e procesit edukativo-arsimorë, kjo shkollë ka pesë zyra për personelin e shkollës drejtor, pedagog/psikolog,bibliotek dhe sekretar-arkatar. Në periudhën e ardhëshme shkolla ka nevojë për renovimi e shkollës në pjesën e jashtme.

Në vitin 2008 shkolla u renovua tërësisht në pjesën e mbrendëshme u instalua nxemja qëndrore. Ndërsa në vitin 2018 është bërë fasadimi i jashtëm i shkollës periferike në shkollën periferike në fshatin Llaskarcë, në vitin 2019 u bë fasadimi i shkollës qëndrore në fshatin Bojanë, poashtu dhe shtruarja e oborit të shkollës me pllaka bekatone në shkollën qëndrore.

Poashtu vazhdimisht janë bërë riparime dhe përmirësime në të tri objektet shkollore, mirëmbajtjen e tyre dhe krijimin e ambientit sa më të përshtatshëm për nxënësit.

Që nga viti 2022 filluan punimet për ndërtimin e një objekti të ri shkollor në f.Paniçar në lokacion të ri dhe punimet ende vazhdojnë dhe janë afër përfundimit dhe lëshimit në përdorim.

Shkolla qëndrore së bashku me ato periferike disponon me një sipërfaqe shfrytëzuese prej afro 1032 m<sup>2</sup>, në formë të lokaleve.

Të theksojmë se në fshatin Bojanë mësimi prej klasës së parë deri në klasën e nëntë është zhvilluar dhe zhvillohet në gjuhën shqipe, po ashtu edhe shkollat periferike Llaskarcë dhe Paniçarë mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Në fshatin Paniçarë mësimi mbahet në klasë të kombinuara I-II-IV, III-V, VI-VII, VIII-IX.. Prej themelimit shkolla ka këtë emër, kanë dalë mjaft gjenerata të suksesshme nxënësish të cilët për rezultatet e arritura janë shpërblyer nëpër shumë gara në nivel komunal, të qytetit të Shkupit, Republikan dhe më gjërë. Vlen të përmendet se pas kryerjes së arsimit fillor një numër i madh i nxënësve vazhdojnë në shkolla të mesme dhe fakultete. Një numër i tyre sot janë arsimtarë në këtë shkollë ku me sukses realizojnë procesin edukativo-arsimorë. Me zhvillimin edhe më të madh të përgjithshëm ekonomik, decentralizimin e suksesshëm dhe krijimin e subjektit komunal efikas bazik në këtë shkollë do të zhvillohet edhe më tepër dhe më me sukses.

## **PROFILET KADROVIKE DHE ZHVILLIMI I SHKOLLËS**

Qëllimi i përgjithshëm i shkollës bazohet në edukimin dhe arsimimin e brezit të ri ( prej I deri në IX sipas ligjit të ri për arsim fillor ) me qëllim që nxënësit të jenë sa më të përgatitur për vazhdimin e shkollimit nëpër shkolla të mesme të të gjitha profileve. Në këtë drejtim shkolla bën dhe do të bëjë përpjekje permanente në bazë të të gjitha mundësive hapësirore dhe kadrovike, nivelit të modernizimit të saj dhe përmirësimit të kushteve që i kërkon koha. Një ndër aktivitetet e shkollës do të jetë zhvillimi dhe aftësimi individual i nxënësve, motivimi i tyre, dëshira, afiniteti dhe aftësimi permanent kreativ me qëllim të krijimit të mundësive optimale për inkuadrimin e tyre në shoqëri dhe shkollim të mëtutjeshëm. Në këtë drejtim rol bazik ka trupi arsimor, kualifikimi dhe aftësimi i tyre profesional si kusht i domosdoshëm për zhvillimin e mëtutjeshëm të shkollës në fjalë. Prandaj vazhdimisht do t'i kushtohet rëndësi këtij segmenti dhe në shkollë të angazhohen kuadro me kualifikime përkatëse dhe profesionalisht të aftësuara.

## **KUSHTET PËR PUNË DHE VENDOSJA TERRITORIALO – ORGANIZATIVE**

Shkolla fillore komunale “ IBE PALIKUQA “ selinë e saj e ka ne fshatin Bojanë. Në përbërje të kësaj shkolle qendrore përfshihen edhe dy shkolla periferike, njëra ne fshatin Llaskarcë dhe tjetra në fshatin Paniçarë.

Në shkollën qendrore mësimi dhe procesi edukativio-arsimorë zhvillohet prej klasës së I-IX, edhe atë në gjuhën shqipe, gjithashtu edhe në shkollën periferike në fshatin Llaskarcë mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe prej kl. I-IX, në shkollën periferike të Paniçarit mësimi zhvillohet në klasë të kombinuara I-II-IV, III-V, VI-VII, VIII-IX.

Kushtet në të cilat organizohet dhe realizohet mësimi dhe procesi edukativo-arsimor janë relativisht optimale dhe mundësojnë realizimin e programeve mësimore, në mënyrë klasike ndërsa nga ky vit shkollor 2024/2025 shpresohet të lëshohet në përdorim edhe kabineti i shkencave natyrore. Vështirësi paraqet mungesa e sallës së edukatës fizike e cila në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndikon në realizimin e programës së lëndës së edukatës fizike.

Ndërtesat ose godinat shkollore në të cilat realizohet procesi edukativo-arsimorë në përgjithësi janë në gjendje të mirë dhe të mirëmbajtura.

Në fshatin Bojanë ku mësimi zhvillohet prej klasës së I-IX në gjuhën shqipe, një pjesë e ndërtesës shkollore është ndërtuar në vitin 1935 dhe me material të dobët. Mirëpo disa herë janë bërë riparime dhe adaptime dhe kështu edhe kjo pjesë e ndërtesës ofron kushte elementare për mbajtjen e mësimit por vetëm në formë klasike.Pjesa tjetër e ndërtesës është shtuar në vitin 1967 dhe është ndërtuar me material të fortë. Edhe kjo pjesë me riparime permanente dhe mirëmbajtje mundëson orgainizimin dhe mbajtjen e mësimit klasik.Mësimi mbahet në 8 klasa, një lokal të adaptuar për klasë dhe një lokal për klasën e parë nëntëvjeçare.

Godina e shkollës periferike në fshatin Llaskarcë është ndërtuar në vitin 1948 me material të dobët. Mësimi organizohet dhe mbahet në 4 klasa dhe në dy ndrrime dhe një lokal hapësirorë të adaptuar për organizimin e mësimit të klasës së ( I ) parë.

Godina e shkollës periferike në fshatin Paniçarë është ndërtuar në vitin 1967 me material të fortë ndërtimor dhe është në gjendje jo të mirë fizike. Shkolla mirëmbahet në mënyrë permanente me qëllim që të ofrojë kushte optimale për mbajtjen e mësimit. Shkolla ka katër klasë( dy jofunkionale), mësimi zhvillohet në klasë të kombinuara dhe në një ndrrim. Nga ky vit akademik shkollor 2024/2025 shpresohet që mësimi të fillohet në godinën e re shkollore që është në fazën përfundimtare të ndërtimit të saj.

Në shkollën qendrore në fshatin Bojanë, ku siç u theksua edhe më lartë nuk ka kabinete dhe sallë të edukatës fizike, kushtet hapësirore të tanishme megjithatë mundësojnë tërësisht përfshierjen e nxënësve të regjistruar për vijimin e mësimit prej klasës së I-IX. Në shkollë nuk ka

qëndrim ditor dhe poashtu nuk ekziston edhe uzin për ushqimin e nxënësve. Ky aktivitet organizohet përmes organizatave të ndryshme të cilat e sigurojnë shkollën, respektivisht nxënësit e interesuar me produkte ushqimore, që i sjellin për çdo ditë. Në shkollën qendrore në Bojanë mungojnë edhe disa lokale hapësirore, si për shembull punëtorja për hausmjeshtër, kabineti për edukatë muzikore, informatik dhe shkenca natyrore dhe minimum një mësojtore. Do të ndërmerren të gjitha masat që në të ardhmen të plotësohen edhe këto nevoja.

Në shkollën qendrore në fshatin Bojanë, shprehur me numra, hapësira shkollore është 617 m<sup>2</sup> ose mesatarisht 1.13 m<sup>2</sup> për nxënë.

Në shkollën periferike në fshatin Llaskarcë hapësira shkollore ku organizohet mësimi është 306 m<sup>2</sup> ose mesatarisht 1.35 m<sup>2</sup> për nxënë.

Në shkollën periferike në fshatin Paniçarë hapësira shkollore ku organizohet mësimi është 108 m<sup>2</sup> ose mesatarisht 4.62 m<sup>2</sup> për nxënë.

#### - Të dhënat e përgjithshme të shkollave

<b>Emri i shkollës</b>	Shkolla F.K “ “ IBE PALIKUQA “ “ - f. Bojanë
<b>Adresa, komuna, vendi</b>	f. Bojanë – Komuna Saraj – Shkup
<b>Telefoni mob</b>	072219440
<b>Fax</b>	2051 – 054
<b>e-mail</b>	<a href="mailto:ibe.palikuqa@gmail.com">ibe.palikuqa@gmail.com</a> <a href="mailto:ou-ibepalikuqa-bojane-saraj@schools.mk">ou-ibepalikuqa-bojane-saraj@schools.mk</a>
<b>Themeluar prej</b>	Komuna IDADIJA 1965
<b>Verifikimi – Numri i aktit</b>	11-587/16 – 31.01.1986
<b>Viti i verifikimit</b>	20 / 1986
<b>Gjuha në të cilën zhvillohet mësimi</b>	Gjuhë shqipe
<b>Viti i ndërtimit</b>	1935
<b>Sipërfaqja e objektit</b>	1125 m <sup>2</sup>
<b>Sipërfaqja e oborrit shkollor</b>	920 m <sup>2</sup>
<b>Sipërfaqja e terrenit sportiv</b>	720 m <sup>2</sup>
<b>Shkolla punon në ndërime</b>	Dy ndërime
<b>Mënyra e nxemjes së shkollës</b>	Me naftë
<b>Numri i klasave</b>	9



<b>Numri i paraleleve</b>	18
<b>Numri i ndëremeve</b>	2

<b>Emri i shkollës</b>	Shkolla F.K “ “ IBE PALIKUQA “ “ - f. Llaskarcë
<b>Adresa, komuna, vendi</b>	f. – Llaskarcë, Komuna Saraj – Shkup
<b>Telefoni</b>	072219440
<b>Fax</b>	2059 – 602
<b>e-mail</b>	<a href="mailto:ibe.palikuqa@gmail.com">ibe.palikuqa@gmail.com</a> <a href="mailto:ou-ibepalikuqa-bojane-saraj@schools.mk">ou-ibepalikuqa-bojane-saraj@schools.mk</a>
<b>Themeluar prej</b>	Komuna IDADIJA 1965 – katërvjeçare
<b>Verifikimi – Numri i aktit</b>	11-587/16 – 31.01.1986
<b>Viti i verifikimit</b>	20 – 1986
<b>Gjuha në të cilën zhvillohet mësimi</b>	Gjuhë shqipe,
<b>Viti i ndërtimit</b>	1948
<b>Sipërfaqja e objektit</b>	325 m <sup>2</sup>
<b>Sipërfaqja e oborrit shkollor</b>	306 m <sup>2</sup>
<b>Shkolla punon në ndëreme</b>	Dy ndëreme
<b>Mënyra e nxemjes së shkollës</b>	Me naftë
<b>Numri i klasave</b>	5
<b>Numri i paraleleve</b>	10
<b>Numri i ndëremeve</b>	2

<b>Emri i shkollës</b>	Shkolla F.K “ “ IBE PALIKUQA “ “ - f. Paniçarë
<b>Adresa, komuna, vendi</b>	f. Paniçarë – Komuna Saraj – Shkup
<b>Telefoni</b>	072219440
<b>Fax</b>	2051-054
<b>e-mail</b>	<a href="mailto:ibe.palikuqa@gmail.com">ibe.palikuqa@gmail.com</a> <a href="mailto:ou-ibepalikuqa-bojane-saraj@schools.mk">ou-ibepalikuqa-bojane-saraj@schools.mk</a>
<b>Themeluar prej</b>	Komuna IDADIJA 1965 – katërvjeçare
<b>Verifikimi – Numri i aktit</b>	11-587/16 – 31.01.1986
<b>Viti i verifikimit</b>	20 – 1986
<b>Gjuha në të cilën zhvillohet mësimi</b>	Gjuhë shqipe
<b>Viti i ndërtimit</b>	1967
<b>Sipërfaqja e objektit</b>	108 m <sup>2</sup>
<b>Sipërfaqja e oborrit shkollor</b>	150 m <sup>2</sup>
<b>Shkolla punon në ndëreme</b>	Një ndërim

<b>Mënyra e nxemjes së shkollës</b>	Me drunj
<b>Numri i klasave</b>	4
<b>Numri i paraleleve</b>	4
<b>Numri i ndërimeve</b>	1

**- Kushtet hapësirore për punën e shkollave**

Numri i përgjithshëm i ndërtesave shkollore	3		
Numri i shkollave periferike	2		
Sipërfaqja bruto	1730 m <sup>2</sup>		
Sipërfaqja neto	1098 m <sup>2</sup>		
Numri i tereneve sportive	2		
Numri i kateve	1		
Numri i mësonjëtove	9		
Numri i hapësirave ndihmëse	3		
Biblioteka shkollore	1		
Mënyra e ngrohjes së shkollës	Me naftë dhe drunjë		

**- Kushtet materiale-teknike**

<b>Kushtet materiale-teknike</b>	<b>Numri</b>
Televizor	1
Kompjuter	11
LCD	2
Fotokopir	4
Printer	5
Kasetofon	1
Harta gjeografike	15
Faks	1

Fotoaparati	0
Projektor	11

- **Struktura e shkollës**

Këshilli i shkollës (Emri dhe mbiemri)	1. Zamir Avdiu - Kolegiumi arsimorë 2. Rauf Pajaziti - Kolegiumi arsimorë 3. Zade Ademi - Kolegiumi arsimorë 4. Qenan Ramadani - Komuna e Sarajit 5. Tefik Memedi - Këshilli I prindërve (kryetar) 6. Azem Zendeli - Këshilli i prindërve 7. Agron Ajdini - Këshilli i prindërve 8. Samet Misimi - Këshilli i prindërve
Aktivitetet profesionale ( llojet )	Aktivi i gjuhëtarëve - udhëheqës: Zade Ademi Aktivi i lëndëve natyrore - udhëheqës: Zejnie Jakupi Aktivi i shkathtësive - udhëheqës: Zamir Avdiu Aktivi i klasave të ulta – Rakibe Beluli
Bashkësia e klasës (numri i nxënësve)	50

Klasa	Gjithsej	Struktura etnike dhe gjinore e punësuarve									
		Maqedonë		Shqiptarë		Turq		Romë		Të tjerë	
		M	f	m	f	m	F	m	f	M	f
<b>Numri i të punësuarve</b>	63	/		28	35						
<b>Numri i kudrit arsimor</b>	49	/		17	32						
<b>Numri i bashkëpunëtorëve profesional</b>	3	/	/	1	2						
<b>Punëtorë administrativ</b>	2	/	/	1	1						
<b>Shërbimi teknik</b>	8	/	/	8	/						
<b>Drejtor</b>	1	/	/	1	/						

- **Shkalla e arsimimit të të punësuarve**

Arsimi	Numri i të punësuarve
Arsimi sipëror, magistër	2
Arsimi i lartë profesional	48
Arsimi i mesëm	6
Arsimi fillor	7

- **Struktura e moshave të të punësuarve**

Vitet	Numri i të punësuarve
20-30	10
31-40	26
41-50	10
51-60	13
61-pension	4

**-Nxënësit** (tabela unifikuese, numri i nxënësve, struktura e nxënësve.)

Struktura etnike dhe gjinore e nxënësve për vitin shkollor 2024/2025																
Klasa	Nr. i paraleleve	Bojanë			Nr. i paraleleve	Llaskarcë			Nr. i paraleleve	Paniçarë			Nr. i paraleleve	Gjithësej		
		Shqiptarë				Shqiptarë				Shqiptarë				Bojanë, Llaskarcë, Paniçarë		
		Gj	M	F		Gj	M	F		Gj	M	F		Gj	M	F
I	1	16	8	8	1	21	13	8		0	0	0	2	37	21	16
I	1	16	7	9									1	16	7	9
II	1	13	7	6	1	22	9	13	*	7	7	0	2	42	23	19
II	1	14	8	6									1	14	8	6
III	1	13	9	4	1	16	10	6	*	3	2	1	2	32	21	11
III	1	13	7	6	1								2	13	7	6
IV	1	18	12	6	1	14	8	6	1**	3	1	2	3	35	21	14
IV	1	23	18	5		14	8	6					1	37	26	11
V	1	15	3	12	1	19	11	8	1**	4	2	2	3	38	16	22
V	1	14	5	9									1	14	5	9
I-V	10	155	84	71	6	106	59	47	2	17	12	5	18	248	125	123
VI	1	14	8	6	1	17	10	7	*	4	2	2	2	35	20	15
VI	1	10	6	4									1	10	6	4
VII	1	19	7	12	1	15	9	6	*	4	1	3	2	38	17	21
VII	1	21	10	11									1	21	10	11
VIII	1	11	6	5	1	13	5	8	1**	1	0	1	3	25	11	14
VIII	1	13	10	3									1	13	10	3
IX	1	11	6	5	1	15	9	6	1**	2	2	0	3	28	17	11
IX	1	13	5	8									1	13	5	8
VI-IX	8	112	58	54	4	60	33	27	2	11	5	6	14	183	96	87
I-IX	18	267	142	125	10	166	92	74	4	28	17	11	32	431	221	210

### **Gjuha mësimore**

	Gjuha mësimore-gjuhë maqedone	Gjuha mësimore-gjuhë shqipe	Gjuha mësimore-gjuhë turke	Gjuha mësimore-gjuhë serbe
Numri i klasave		32		
Numri i nxënësve		431		
Numri i arsimtarëve		49		

### **3. MISIONI I SHKOLLËS**

Roli kryesor dhe misioni i kësaj shkolle është që të mësojë dhe arsimojë nxënës të të gjitha bashkësive etnike, bazuar në konceptin për edukim dhe arsim fillor nëntëvjeçar duke implementuar suksesshëm programet e reja mësimore dhe duke i pajisur me njohuri të nevojshme, shkathtësi dhe aftësi që të përballen me sukses me të gjitha vështirësitë që dalin nga procesi edukativo-arsimor.

Misioni i shkollës do të lëvizë në drejtim të aftësisë dhe edukimit të nxënësve të të gjitha bashkësive etnike, për një sjellje shoqërore me përgjegjësi ndaj shkollës, shokëve e shoqeve dhe rrethit ku jetojnë veprojnë, mbi baza të parimeve demokratike, tolerancës, mirëkuptimit të ndërsjellë të posedimit të iniciativave, konstruktivitetit dhe aftësisë.

Duke u nisur roli mjaft i rëndësishëm edukativo-arsimorë dhe roli në mjedisin ku vepron dhe shoqëritë në përgjithësi, kjo shkollë do të jetë e hapur për bashkëpunim me të gjitha subjektet e interesuara, e në veçanti me mjedisin lokal, prindët, komunën etj.

### **VIZIONI I SHKOLLËS**

Vizioni i kësaj shkolle do të bazohet në shumë komponente që kanë të bëjnë me programet sa më të përsosura edukativo-arsimorë, kualifikimet dhe rikualifikimet e trupit edukativo-arsimor dhe aftësimin permanent të tyre profesional në përputhshmëri me kërkesat e kohës në iniciativat e ndryshme individuale dhe kolektive në organe, organizata, këshillat prindërore, subjekte të ndryshme komunale dhe republikane që kanë të bëjnë me arsimin fillor dhe më gjërë nga bashkëpunimi në mjedisin lokal, Komuna e Sarajit si dhe faktorë të tjerë të ndryshëm të jashtëm e të brendshëm.

Duke u nisur gjendja momentale në shkollë, rezultatet e deritanishme, punës dhe angazhimit profesional të kuadrit arsimor, rrethanat e ndryshme pozitive, vizionin e shkollës sonë e definojmë si imperative që :

“ Të ndërtojë kushte të shkëlqyeshme për mësim bashkëkohor më forma, metoda dhe mjete të reja për mësim, duke bashkëpunuar vazhdimisht me prindët e nxënësve dhe duke u bërë shëmbull për gjeneratat e reja të të gjitha bashkësive etnike “. 13

#### **4. “Lessons Learned” – E mësuar/Përvoja të fituara**

Vitin e kaluar mësimorë, në bazë të vetevaluimit të realizuar në shkollë dhe në bazë të prioriteteve që i përcaktuam, me sukses realizuam një numër të madh të aktiviteteve të punës edukativo – arsimore.

Si rezultat i të gjitha aktiviteteve në fund të vitit shkollorë u arritën rezultate solide në mësim, vlerësimin ekstern. Morrëm pjesë në garat komunale ku u arritën rezultate solide. U realizuan një numër i madh i projekteve. Edhe këtë vit shkollorë do të vazhdojmë me të gjitha aktivitetet tjera dhe do të tentojmë që të arrijmë rezultate edhe më të mira krahas vitit të kaluar.

#### **5. Fusha e ndryshimeve, prioriteteve dhe qëllimeve**

Në bazë të vetë evaluimit të realizuar në shkollë që u bazua në përcjelljen, analizimin dhe vlerësimin e punës gjatë dy viteve dhe përcaktimi i anëve të fuqishme dhe të dobëta në shtatë fushat nga ana e grupeve punuese, të përcaktuara janë prioritetet vijuese :

- Përfundim i furnizimit me mjete teknike dhe me vegla;
- Përsosje profesionale e kuadrit mësimdhënës;
- Thellim i kuadrit mësimdhënës me TIK;
- Thellimi i aktiviteteve në suaza të programit “Integrimi i edukimit ekologjik në sistemin arsimorë të Maqedonisë”;
- Inkuadrimi i prindërve në përmirësimin e arritjeve të nxënësve në gjithë procesin edukativo – arsimorë.
- Zbatimi i metodave interaktive dhe TIK në procesin arsimorë me qëllim që të përmirësohet ambienti i mësimi që nxënësit duhet ta përjetojnë si ambient motivues kurse mënyra e mësimi më interesant;
- Ngritja e nivelit të përgjithshëm të kulturës shëndetësore të nxënësve.
- Bashkëpunim më i madh me organizatat ekonomike dhe me tregun e fuqisë së punës.(promovimi i shkollës)
- Arsimtarët me rregull të shfrytëzojnë teknologjinë informative me qëllim që të implementohet komunikimi më i mirë me prindërit e nxënësve.

- Shkolla të kushtoj vëmendje për sigurimin e mjeteve për përkrahje financiare për përkrahje të kuadrit mësimdhënës për pjesëmarrje në trajnime, kongrese, seminare dhe manifestime të tjera profesionale;
- Bibloteka shkollore të pasurohet me literaturë profesionale;
- Salla e edukatës fizike në të cilën mund të realizohet procesi mësimorë sipas planeve dhe programeve mësimore;
- Përsosje profesionale e arsimtarëve (trajnim për punë me nxënësit me nevoja të posaçme), programe mësimore për nxënësit me nevoja të posaçme;
- Pjesëmarrje më e madhe e prindërve në aktivitete të ndryshme në shkollë.
- Përpilimi i analizës për gjendjet e ambientit jetësorë. Sipas analizës është përpiluar plani i aktiviteteve në të cilin janë të përfshira pikat e aksionit nga eko standardet ku theksi do të vihet vitit shkollorë 2024/25 dhe do të realizohen aksione dhe fushata për ngritje të vetëdijes ekologjike dhe realizimin e eko standardeve.

## **INTEGRIMI NDËRETNIK NË ARSIM**

Secila shkollë e krijon politikën e saj për promovimin e integritit ndëretnik në arsim dhe i planifikon aktivitetet sipas karakteristikave të vetë shkollës. Megjithatë, secila shkollë duhet të realizojë aktivitete të përbashkëta me nxënës që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore.

Me projektin për integrimin ndëretnik në arsim, shkolla u mundëson nxënësve të zhvillojnë respekt, si të kulturës së tyre, ashtu edhe të kulturave të bashkësive të tjera etnike që jetojnë në R.M.V. Nxënësit mësojnë për tolerancën, respektimin e dallimeve dhe kultivimin e vlerave të jetesës së përbashkët në shoqëri multikulturore.

Shkolla duhet të siguron klimë në të cilën kultivohet barazia për të gjithë dhe në të cilën ndërmerren masa për mbrojtjen e nxënësve nga të gjitha format e diskriminimit.

Integrimi ndëretnik në arsim paraqet investim në ardhmërinë e fëmijëve dhe të rinjve, sepse u ndihmon të bëhen qytetarë të përgjegjshëm që dinë të jetojnë bashkërisht në shoqëri multikulturore/multi-etnike dhe bashkërisht të kontribuojnë për zhvillimin e shoqërisë së tillë.

Nxënësit që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore, do të marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta përmes orëve të përbashkëta dhe ose projekte hulumtuese ose në aktivitete jashtëmësimore dhe të lira të nxënësve, siç janë ekskursionet, shfaqjet teatrale, lojërat sportive etj. Gjatë kësaj duhet të kemi parasysh se:

- planifikimi i aktiviteteve të përbashkëta është një parakusht i rëndësishëm për realizimin e tyre të suksesshëm;



- aktivitetet e përbashkëta janë të realizueshme nëse janë mjaft tërheqëse për nxënësit – burojnë nga interesi i tyre dhe i motivojnë për angazhim serioz dhe afatgjatë;
- për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta njësoj janë të rëndësishme produkti që është përcaktuar përmes qëllimit të përbashkët dhe interaksioni i drejtpërdrejtë në procesin e ardhjes deri të produkti.

Përmes përvojës së kontaktit të organizuar të ndërsjellë dhe interaksionit të drejtpërdrejtë, nxënësit:

- Mësohen të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin;
- Fillojnë t'i dallojnë dhe t'i pranojnë ngjashmëritë e ndërsjella
- t'i respektojnë dallimet e ndërsjella;
- Krijojnë vetëbesim të ndërsjellë;
- Përvetësojnë shkathtësi për jetë të përbashkët në mjedis multietnik.

Kontakti dhe interaksioni i drejtpërdrejtë kontribuojnë për pakësimin e stereotipave dhe paragjykimeve negative ndaj të tjerëve.

Shkollat do të planifikojnë një numër të madh të aktiviteteve, ku disa aktivitete realizohen në nivel të shkollës (edhe në shkollat njëgjuhëshe edhe në ato shumëgjuhëshe), ndërsa disa të tjera realizohen ndërmjet SHKOLLAVE PARTNERE me gjuhë të ndryshme mësimore:

#### **AKTIVITETET E PËRBASHKËTA MËSIMORE**

- Orë të përbashkëta (për shembull, në lëndën e gjuhës së huaj, në lëndën e edukatës fizike dhe shëndetësore dhe/ose në lëndën e artit figurativ).
- Aktivitete projektuese në kuadër të lëndëve të rregullta.
- Mësim në natyrë.
- Aktivitete projektuese në arsimin gjimnazist.
- Orë të lira në shkollat profesionale.

#### **AKTIVITETE E PËRBASHKËTA AFATSHKURTRA JASHTËMËSIMORE**

- Ekskursionë, piknikë dhe vizita.
- Gosti dhe vizita të ndërsjella.
- Shfaqje dhe festime.
- Mbrëmje të gjysmëmaturës/maturës dhe ahengje të tjera.
- Ahengje dhe ngjarje të tjera sociale.
- Aksione ekologjike.
- Ngjarje në komunitet/komunë.

## **INTEGRIMI I EDUKATËS EKOLOGJIKE NË PROCESIN MËSIMOR**

Gjatë këtij viti shkollor planifikohet edhe programi “ Integrimi i edukatës ekologjike në procesin mësimor “ i cili përfshin planifikimin e integruar “ Lidhshmëri me programet mësimore “. Në planet vjetore do të përfshihet planifikimi i integruar me futjen e pikave nga 4 Eko-standardet në lëndët ekzistuese mësimore dhe numrin e orëve pa ndryshuar planet mësimore.

I Eko-standard : Kursimi i energjisë

II Eko-standard : Kursimi i ujit

III Eko-standard : Mirëmbajtja e objekteve dhe mjedisit në shkollë

IV Eko-standard : Oborr i rregulluar dhe ekologjik

Të gjitha këto 4 Eko-standardet kanë edhe qëllimet të cilat shkolla duhet ti realizon gjatë një viti shkollor.

I Eko-standard : Kursimi i energjisë

Qëllimi : Zvogëlimi i harxhimit të energjisë për 10% në krahasim me vitin e kaluar.

II Eko-standard : Kursimi i ujit

Qëllimi : Zvogëlimi i harxhimit të ujit për 10% në krahasim me vitin e kaluar.

III Eko-standard : Mirëmbajtja e objekteve dhe mjedisit në shkollë

Qëllimi : Sigurimi i kushteve të shëndetshme për mësim dhe punë në shkollë.

IV Eko-standard : Oborr i rregulluar dhe ekologjik

Qëllimi : Kopsht të rregulluar funksional sipas parametrave ekologjik në mënyrë maksimale të shfrytëzohet për nevojat e të gjithë të pranishmive në shkollë.

Gjithashtu do të përpunohet “Plani i aktiviteteve“ në bazë të analizës së bërë të gjendjes së mjedisit jetësor dhe do të jetë në korelacion me pikat e futura në planifikimin e integruar. Në fakt, pikat të cilat do ti zgjedhim në planin e aktiviteteve për realizim gjatë vitit shkollor duhet të jenë të integruara në mësim nëpërmjet planifikimit të integruar, ku do të përcaktohen lëndët, përmbajtjet mësimore, klasat dhe koha e realizimit gjatë këtij viti shkollor.

PROGRAMI “ INTEGRIMI I EDUKATËS EKOLOGJIKE NË SISTEMIN  
ARSIMOR MAQEDONAS  
PLANIFIKIM I INTEGRUAR NË MËSIM

**Sh. F.K "IBE PALIKUQA" f.Bojanë -Shkup**  
**Viti shkollor 2024/25**  
**(mësimi lëndor)**

**I EKO-STANDARD: Kursimi i energjisë elektrike**

Fusha : Përdorimi racional i energjisë elektrike dhe termike në ndërtesën shkollore.

Qëllimi : Zvogëlimi i harxhimit të energjisë elektrike dhe termike për 10 % në krahasim me vitin e kaluar.

Pika e akcionit	Lënda	Përmbajtja	Klasa	Koha e realizimit
1.Zavendësimi i të gjitha llambave me llamba elektrike për kursim.	Gjuhë angleze	Ushtrime gram."Kërkim dhe zbulim"	VIII	Janar
	Fizikë	"Rryma elektrike "	VIII	Dhjetor
4.Plan për zvogëlimin e harxhimit për burimet e nxemjes ( DRUNJË)-përdorim racional dhe planifikimi për burimet e nxemjes.	Arsim teknik	Përdorimi i energjisë në ndërtimtari	VI	Tetor
	Arsim teknik	Përdorimi i energjisë diellore	V	Maj
	Gjeografi	Energjia dhe miniera	VI	Prill
	Fizikë	Kursimi i energjisë	VII	Prill
6.Pastrimi i rregullt i dritareve ( njëherë në javë ) për shfrytëzimin maksimal të energjisë diellore.				
7.Theksimi i udhëzimeve për përdorim racional të energjisë elektrike dhe termike.				

## II EKO-STANDARD: Kursimi i ujit

Fusha : Përdorimi racional i ujit në ndërtesën shkollore dhe në oborr.

Qëllimi : Zvogëlimi i harxhimit të ujit për 10 % në krahasim me vitin e kaluar.

Pika e akcionit	Lënda	Përmbajtja	Klasa	Koha e realizimit
1.Analizë e gjendjes së instalimit të ujësjesit (ceva, slavina ,kazan, etj.).	Matematikë	Matje	V	Maj
	Kimi	Përbërja e acideve	VII	Maj
2.Zavendësimi dhe sanimi i çeshmave jofunkionale në ndërtesën shkollore .	Matematikë	Vëllimi i katrorit	VIII	Prill
5. Theksimi i udhëzimeve për përdorim racional të ujit.	Gjuhë shqipe	"Kurseni ujin për të mirën e njerëzimit"	VIII	Tetor
	Gjuhë shqipe	"Uji – burim i jetës"	VII	Mars
	Gjeografi Biologji	Hidrografija e R.M.V. Bimët në ciklin e ujit	VI	Nëntor
6.Emërimi i personave përgjegjës në përputhshmëri me numrin e paraleleve dhe ndërrimet në shkollë për zbatimin e pikave të akcionit të lartëpërmendura.	Gjuhë angleze	"Jetojmë shëndetshëm"	VI	Prill
7.Formimi i eko-patrolave ( grupë e nxënësve ) të përfshirë në realizimin e pikave të akcionit, të cilët do ta përcjellin dhe kontrollojnë procesin e implementimit të këtyre aktiviteve.	Gjuhë angleze	Ushtrime gramatikore "Jetojmë shëndetshëm"	VI	Prill

### III EKO-STANDARD: Mirëmbajtja e ndërtesës dhe mjedis të shëndetshëm në shkollë

Fusha : Mjedis të brendshëm të shëndetshëm dhe të pastërt për mësim dhe punë.

Qëllimi : Sigurimi i kushteve të shëndetshme për mësim dhe punë në shkollë.

Pika e akcionit	Lënda	Përmbajtja	Klasa	Koha e realizimit
1.Largimi i gjërave të panevojshme në shkollë ( banka të thyera,vaza, tabela, lule të vjetra dhe të thata etj.).	Gjuhë shqipe	"Projekt ekologjik "	VI	Nëntor
	Arsim muzikor	Largimi i gjërave të panevojshme (tela të mandolinave ) zavendësimi me të reja	VIII	Nëntor
	Shkencat natyrore dhe arsim teknik	Pastrimi i materialeve dëmtuese	VI	Mars
	Shkencat natyrore dhe arsim teknik	Reciklim	VI	Maj
	Etika	Mjedis i shëndetshëm	VI	Mars
2.Pastrimi i korridoreve ( pas çdo ndërrimi),zyrave, mësonjëtove dhe sallave të edukatës fizike (garderoba,etj.) me mjete të ndryshme .	Kimi	Masat për mbrojtjen në ambientin shkollor	VII	Shtator
	Kimi	Zbërthimi	VII	Tetor

5.Zbukurimi i korridoreve, zyrave dhe mësonjëtove me lule.	Gjuhë shqipe	"Projekt ekologjik "	VI	Mars
	Informatikë	Eko - projekt (prezentim multimedial )	VI VI VI	Dhjetor Tetor Shtator
	Arsim figurativ	Interier i brendshëm i ndërtesës	VII VIII	Tetor Maj

### III EKO-STANDARD: Oborr të rregulluar dhe ekologjik

Fusha : Oborr të rregulluar dhe funksional që është në pajtueshmëri me nevojat për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Qëllimi : Oborr të rregulluar funksional sipas të gjitha parametrave ekologjik në mënyrë që maksimalisht do të shfrytëzohet për nevojat e të gjithë të pranishmive në shkollë.

Pika e aksionit	Lënda	Përmbajtja	Klasa	Koha e realizimit
1.Largimi i gjërave dhe bimëve të panevojshme dhe jofunksionale nga oborri (lule dhe drunjë të thatë, banka të thyera, korpa të thyera etj.).	Biologji	Rëndësia e bimëve për jetën në planetin tonë	VI	Maj
2. Mbjellja e drunjëve local në çdo 5m2 .	Gjuhë angleze	"Projekt ekologjik "	VII	Dhjetor
	Arsim fizik dhe shëndetësor	"Dita e drurit"	VII , VIII	Mars Tetor
	Arsim figurative	Rregullimi i oborrit shkollor	VI VI	Mart April
4.Mbjellja e luleve lokale.	Gjuhë maqedonase	Teksti-"Moja kitka "	VI	Maj
5.Rrethimi i oborrit me gardh të gjallë dhe vendosja e karrikeve.	Arsim fizik dhe shëndetësor	"Dita e ekologjisë "	VII,VI II	21 Mars
	Kimi	Mbjellja e drunjëve të rinj	V-VIII	Prill

9.Pastrim i rregullt i oborrit .				
10.Mirëmbajtja e gjelbërimit ( kositje e rregullt e gjelbërimit dhe kositja e barit)	Gjeografi	Rëndësia e tokave pjellore	VI	Dhjetor
	Biologji	Baraspesha në natyrë	VI	Maj
	Projekte nga informatika	Eko-projekt,,Dita e planetit” .	VI VII	Prill Prill
	Arsim figurativ	Rregullimi i oborrit shkollor	VIII	Dhjetor

**PROGRAMI “ INTEGRIMI I EDUKATËS EKOLOGJIKE NË SISTEMIN  
ARSIMOR MAQEDONAS  
PLANIFIKIM I INTEGRUAR NË MËSIM**

**Shkolla F.K "IBE PALIKUQA" f.Bojanë-Shkup  
Viti shkollor 2024/2025 (mësimi klasor)**

**I EKO-STANDARD: Kursimi i energjisë elektrike**

Fusha : Përdorimi racional i energjisë elektrike dhe termike në ndërtesën shkollore.

Qëllimi : Zvogëlimi i harxhimit të energjisë elektrike dhe termike për 10 % në krahasim me vitin e kaluar.

<b>Pika e akcionit</b>	<b>Lënda</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Klasa</b>	<b>Koha e realizimit</b>
1.Zavendësimi i të gjitha llambave me llamba elektrike për kursim.	Matematikë	Mbledhje dhe zbritje deri 20 me kalim	III	Shtator
	Matematikë	Numrat prej 1-10 dhe prej 10-1	I	Prill
	Arsim teknik	Detyrë projektuese: Aparatet teknike në shtëpinë tënde	V	Maj
4.Plan për zvogëlimin e harxhimit për burimet e nxemjes ( DRUNJË)-përdorim racional dhe planifikimi për burimet e nxemjes.	Matematikë	Mbledhje dhe zbritje e numrave deri 1000 me kalim	IV	Tetor

6.Pastrimi i rregullt i dritareve ( njëherë në javë ) për shfrytëzimin maksimal të energjisë diellore.	Matematikë	Shfrytëzimi i energjisë elektrike	V	Dhjetor
	Mjedisi im	Inventari i shkollës	II	Tetor
	Arsim teknik	Detyrë projektuese: Shfrytëzimi i burimeve për energjinë diellore	V	Maj
	Gjuhë angleze	Nxemja globale	V	Maj
7.Theksimi i udhëzimeve për përdorim racional të energjisë elektrike dhe termike.				

## II EKO-STANDARD: Kursimi i ujit

Fusha : Përdorimi racional i ujit në ndërtesën shkollore dhe në oborr.

Qëllimi : Zvogëlimi i harxhimit të ujit për 10 % në krahasim me vitin e kaluar.

Pika e aksionit	Lënda	Përmbajtja	Klasa	Koha e realizimit
1.Analizë e gjendjes së instalimit të ujës-jellësit ( ceva, slavina ,kazan etj.) .	Gjuhë shqipe	Përshkrimi i sendeve duke i vëzhguar	II	Nëntor
2.Zavendësimi dhe sanimi i çeshmave jofunksionale në ndërtesën shkollore .	Gjuhë shqipe	Kush di të rregullojë ?	III	Nëntor
5. Theksimi i udhëzimeve për përdorim racional të ujit.	Gjuhë shqipe	Furça për dhëmbë dhe sapuni	III	Shtator
	Matematikë	Litri	III	Maj
	Natyre	Uji është më i rëndësishëm për jetë dhe gjendja e tij	IV	Dhjetor
	Mjedisi im	Kush sillet drejt	I	Nëntor
Shkencat natyrore	Rëndësia e ujrave në tokë	V	Maj	
Gjuhë angleze	Pasojat nga ndotja e ujit	IV	Tetor	



6.Emërimi i personave përgjegjës në përputhshmëri me numrin e paraleleve dhe ndërrimet në shkollë për zbatimin e pikave të akcionit të lartpërmendura.				
7.Formimi i eko-patrolave ( grupë e nxënësve ) të përfshirë në realizimin e pikave të akcionit, të cilët do ta përcjellin dhe kontrollojnë procesin e implementimit të këtyre aktiviteve.	Shkathësi jetësore	Eko-patrolla	III	Tetor

### III EKO-STANDARD: Mirëmbajtja e ndërtesës dhe mjedis të shëndetshëm në shkollë 23

Fusha : Mjedis të brendshëm të shëndetshëm dhe të pastërt për mësim dhe punë.

Qëllimi : Sigurimi i kushteve të shëndetshme për mësim dhe punë në shkollë.

Pika e akcionit	Lënda	Përmbajtja	Klasa	Koha e realizimit
1.Largimi i gjërave të panevojshme në shkollë ( banka të thyera,vaza, tabela, lule të vjetra dhe të thata etj.).	Matematikë	Mbledhja e të dhënave	III	Qershor
	Arsim fizik dhe shëndetësor	Ngritja dhe bartja e sendeve deri 3 kg.	II	Mars

2.Pastrimi i korridoreve ( pas çdo ndërrimi),zyrave, mësonjëtove me mjete të ndryshme .	Natyre	Ekologjia është shkencë për planetin tonë	IV	Prill
	Arsim figurative	Kujdesi dhe mirëmbajtja e ndërtesës shkollore	V	Tetor
5.Zbukurimi i korridoreve, zyrave dhe mësonjëtove me lule.	Gjuhë shqipe	Lexim : Karanfli i këputur	III	Tetor
	Mjedisi im	Zbukurimi i klasës	III	Tetor
	Shkathësi jetësore	Punëtorja V – 4. 2 " E zbukurojmë klasën"	I	Prill

#### **IV EKO-STANDARD: Oborr të rregulluar dhe ekologjik**

Fusha : Oborr të rregulluar dhe funksional që është në pajtueshmëri me nevojat për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Qëllimi : Oborr të rregulluar funksional sipas të gjitha parametrave ekologjik në mënyrë që maksimalisht do të shfrytëzohet për nevojat e të gjithë të pranishmive në shkollë.

<b>Pika e aksionit</b>	<b>Lënda</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Klasa</b>	<b>Koha e realizimit</b>
1.Largimi i gjërave dhe bimëve të panevojshme dhe jofunksionale nga oborri (lule dhe drunjë të thatë, banka të thyera, korpa të thyera etj.).	Gjuhë shqipe	Rregullimi i oborrit dhe kopshtit shkollor	V	Mars
2. Mbjellja e drunjëve lokal në çdo 5m2 .				
4.Mbjellja e luleve lokale.	Gjuhë shqipe	Bisedojmë – Unë mbjell drunj	III	Prill
5.Rrethimi i oborrit	Gjuhë shqipe	" Lulja e pyllit "	IV	Prill

me gardh të gjallë dhe vendosja e karrikeve.	Shkencat natyrore	Përgatitja e posterit me lule nga mjedisi i afërt	V	Prill - Maj
9.Pastrim i rregullt i oborrit .	Mjedisi im	Oborri shkollor	III	Tetor
	Gjuhë angleze	Bota dhe ekologjia	V	Tetor
10.Mirëmbajtja e gjelbërimit ( kositje e rregullt e gjelbërimit dhe kositja e barit)	Arsim figurativ	Vizatim – Pamje pranverore	II	Mars
	Shkencat natyrore	Masa për mbrojtjen e natyrës	V	Qershor
	Shkathtësi jetësore	Shëtitje e gjelbërt-matje e ndotjes	V	Prill
	Gjuhë angleze	Ruajtja dhe mbrojtja e natyrës	IV	Maj

## 6. Planet aksionare

N.r.	Aktiviteti	Realizator	Koha	Indikator për sukses	Dëshmi	Evaluumi, ideja për përmirësim
1.	Formimi i ekipeve të arsimtarëve për përmirësimin e kushteve dhe punës në shkollë	Drejtori	Maj-Qershor 2025	Koordinimi i detyrave dhe përgjegjësi të punëtorëve. Përmirësimi i punës së ekipit-përpunimi i planeve aksionare	Lista e anëtarëve të ekipeve. Procesverbal nga Këshilli i arsimtarëve,planet aksionare	Evidencë për përfaqësimin e barabartë të të punësuarve për realizimin e detyrave të parashtruara
2.	Ndërtimi i sallës së edukatës fizike	Drejtori	Qershor-Korrik 2025	Krijimi i kushteve të nevojshme për nxjerrjen e mësimin kualitativ nga arsimit fizik dhe shëndetësor	Kërkesë deri te MASH dhe komuna e Sarajit	Përmirësimi i kushteve dhe infrastructures në shkollë

3.	Nevoja për punësimin e defektologut në shkollë	Drejtori	Shtator 2024	Punë me nxënës me nevoja të veçanta	Kërkesë deri te MASH dhe komuna e Sarajit për punësimin e defektologut në shkollë	Krijimi i kushteve për realizimin e suksesshëm të plan-programit mësimor për këtë kategori të nxënësve
4.	Trajnime të arsimtarëve për punë me nxënës me nevoja të veçanta	BZHA	Gusht 2024	Përmirësimi i kushteve për punë me nxënës me nevoja të veçanta, arritja e rezultateve, motivim	Kërkesë e shkruar deri te BZHA	Diseminim
5.	Ritrajnim i kuadrit arsimor për zbatimin e TIK –ut në mësim	Drejtori Pedagogu Arsimtarët	Shtator 2024	Ritje e njohurive, shkathtësi dhe përvojave, si dhe zbatimi i TIK-ut	Realizim i orëve mësimore dhe punëtorive me zbatimin e TIK-ut	Mundësi për vetarsimim dhe mësim nëpërmjet hulumtimit
6.	Furnizimi me mjete didaktike-materiale për fëmijë me nevoja të veçanta	Drejtori	Shtator 2024	Përparimi i njohurive të nxënësve, njohuri të zgjeruara, mundësive, shkathtësive, të nxënësve me nevoja të veçanta dhe bashkëpunim mes nxënësve	Kërkesë për furnizim me mjete didaktike	Bashkëpunim mes nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve

## 7. Plan për evaluimin e planeve aksionare

Në evaluimin e planeve aksionare do të inkuadrohen të gjitha subjektet në shkollë të cilët e realizojnë veprimtarinë edukativo-arsimnore :

- Drejtori me mbikqyrjen e tij me përgatitjen e arsimtarëve, planifikimin e mësimit, kualitetin e realizimit me anë të prezentimit nëpër orët e mësimit, përmes përcjelljeve të rezultateve të arritura në mësim, përcjelljes së aktiviteteve të lira të nxënësve, proekteve, garave të ndryshme, kontakteve me prindët, etj.
- Shërbimi pedagogjik – poashtu përmes analizave të bëra nga testimi i nxënësve, punës së aktiviteteve profesionale, bisedave me nxënësit dhe prindërit, etj.
- Vizitat e përfaqësuesve nga Byroja për zhvillimin e arsimit dhe Ministria e arsimit dhe shkencës
- Reagimet dhe vlerësimet e prindërve përmes formave të bisedave me shërbimin pedagogjik, drejtorin dhe udhëheqësit e paraleleve

**KALENDARI PËR VITIN SHKOLLOR  
2024 / 2025**

- 8 Shtatori 2024 - Dita e pavarësisë së Maqedonisë
- 11 Tetori 2024 - Dita e kryengritjes së Maqedonisë
- 23 Tetori 2024 - Dita e kryengritjes Revolucionare Maqedonase
- 22 Nëntori 2024 - Dita e alfabetit të gjuhës shqipe
- 8 Dhjetori 2024 - “shën Kliment Ohridski”
- 1 Janari 2025 - Festa e Vitit të Ri
- 7 Janari 2025 - Krishtlindjet
- 30 Mars 2025 - Fitër Bajrami
- 6 Maj 2025 - Pashkët
- 1 Maji 2025 - Festa e punëtorëve
- 24 Maji 2025 - “Shën Kirili dhe Metodij”
  
- 5 Qershor 2025 -Kurban Bajrami

**9. Mësimi dhe realizimi mësimor**

**PASQYRË E LOKALEVE NË TË CILAT REALIZOHET MËSIMI DHE LOKALET TJERA**

Nr.	Lloji i lokalit	f.Bojanë		f. Llaskarcë		f. Paniçarë		Gjithsejt	
		Nr. i kl.	m <sup>2</sup>	Nr. i kl.	m <sup>2</sup>	Nr. i kl.	m <sup>2</sup>	Nr. i kl.	m <sup>2</sup>
1.	Mësonjëtove	7	300	4	182	4	108	15	590
2.	Kabinete	1	39	/	/	/	/	1	39
3.	Salla të edukates fizike	/	/	/	/	/	/	/	/
4.	Kabinete për BAT	/	/	/	/	/	/	/	/
5.	Klasa e I nëntëvjeçare	1	45	1	25			2	70
6.	Salla e arsimitarëve	1	25	1	15	1	12	3	52
	Gjithsejt	10	409	6	222	5	120	21	751

### Lokalet për veprimtari shoqërore dhe pedagogjike

Nr.	Lloji i lokalit	f.Bojanë		f. Llaskarcë		f. Paniçarë		Gjithsejt	
		Nr.	m <sup>2</sup>	Nr.	m <sup>2</sup>	Nr.	m <sup>2</sup>	Nr.	m <sup>2</sup>
1.	Zyra e drejtor	1	15	/	/	/	/	1	15
2.	Zyra e pedagogut	1	16	/	/	/	/	1	16
3.	Zyra e sekretarit	1	16	/	/	/	/	1	16
4.	Zyra e hausmjeshtrit	1	10	/	/	/	/	1	10
5.	Zyra e arkatarit			/	/	/	/		
6.	Biblioteka shkollore	1	12	/	/	/	/	1	12
7.	Lokal për akt.të ndrysh.	1	10	1	20	1	16	3	46
	Gjithsejt	6	79	1	20	1	16	8	115

### Pasqyra e personelit udhëheqës, pedagogjik, administrativ dhe teknik për vitin shkollor 2024/2025

Nr.	Vendi i punës	Numri	Shkalla e arsimimit	Emri dhe mbiemri
1.	Drejtor	1	E lartë	Lulzim Mustafa
2.	Pedagog	1	E lartë	Ejup Poliku
3.	Sekretar	1	E lartë	Arjeta Murati
4.	Psikolog	1	E lartë	Ilijana Murtezani
5.	Arkatar-ekonom	1	E lartë	Metush Saliu
6.	Hausmjeshtër	1	E mesme	Mumin Rexhepi
7.	Biblioteka	1	E lartë	Nurten Rexhepi

## Mbajtësit e higjienës

Për mbajtjen e higjienës në shkollën fillore komunale “ Ibe Palikuqa ” f.Bojanë, janë të angazhuar 7 higjienista. Të gjithë janë me përvojë pune disavjeçare. Nxemja në shkollën qendrore dhe periferike në f.Llaskarc bëhet me naftë, kurse në shkollën periferike në f.Paniçarë nxemja bëhet në mënyrë klasike, me dru.

<b>Nr.</b>	<b>Emri dhe mbiemri</b>	<b>Shkalla e arsimimit</b>	<b>Vendi i punës</b>
1.	Zeqir Asani	Fillore	Bojanë
2.	Halim Halimi	Fillore	Bojanë
3.	Avdush Iseni	Fillore	Bojanë
4.	Mensur Asani	Fillore	Bojanë
5.	Avdil Ramadani	Fillore	Llaskarcë
6.	Nadi Ziberi	Fillore	Llaskarcë
7	Shefket Jakupi	Fillore	Paniçarë

Planifikimi i mësimimit dhe mësimdhënies në shkollë realizohet në gjuhën shqipe sipas udhëzimeve të Byros për zhvillim të arsimit dhe M.A.Sh.Në shkollë ka qasje të përcaktuara për planifikimin dhe procedura të veçanta për mbështetjen dhe ndjekjen e planifikimit të mësimimit nga ana e drejtorit, shërbimit profesional ose persona të caktuar nga organet profesionale. Të gjithë arsimtarët kanë planet globale, tematike – mujore (javore) dhe përgaditje ditore, ku me vete përmbajnë drejtime të qarta se çka duhet të pritet prej nxënësit (rezultatet mësimore) si dhe kur duhet të arrihen ato(rezultatet).

Qëllimi i mësimdhënies, rezultatet e pritura dhe mënyra e notimit apo vlerësimit të nxënësve janë të përcaktuara me planifikim. Poashtu edhe aktivitetet e nxënësve janë të planifikuara ashtu qëkoha e të mësuarit dhe mësimdhënies të shfrytëzohet në mënyrë më efektive.

Poashtu edhe puna e aktiveve profesionale në shkollë bëhet në mënyrë të planifuar, duke kontaktuar mes njëri tjetrit, këmbëjnë ide dhe mendime për planifikimin me anë të teknologjive të informimit dhe të komunikimit për punën në shkollë etj.

Orarin e mësimimit e bënë shërbimi profesional në bashkëpunim me arsimtarët por duke e respektuar në rend të parë interesin e nxënësve (fëmijëve).

Mësimi i rregullt edhe në vitin shkollorë 2024/2025 do të zhvillohet si deri më tani : në tre godina shkollore dhe në ate klasor dhe lëndor. Realizimi i procesit edukativo-arsimor do të bëhet sipas plan-programeve mësimore për arsim fillor nëntëvjeçar dhe sipas planit mësimor për arsim fillor tetëvjeçar të derguara nga Ministria e arsimit dhe shkencës- Byroja për zhvillim të arsimit në R.M.V si dhe plan-programet e kuadrit arsimor i cili realizon procesin edukativo-arsimor.

a) **Mësimi lëndor** – organizohet dhe realizohet në të tri shkollat në atë qendrore në fshatin Bojanë dhe në shkollat periferike në fshatin Llaskarcë dhe Paniçarë. Lëndët mësimore janë të përfshira nga lëndët e obliguara dhe ato zgjedhore. Shkolla organizon rregulisht mësim zgjedhor ku planifikohet, organizohet dhe realizohet sipas fondit të paraparë të orëve sipas planit mësimorë. Lënda zgjedhore që do të zgjedhet nga nxënësi bëhet e obligueshme në orarin e tij.

***Lëndët e obliguara :***

1. Gjuhë shqipe
2. Gjuhë maqedonase
3. Gjuhë angleze
4. Gjuhë gjermane
5. Matematikë
6. Histori
7. Gjeografi
8. Kulturë qytetare
9. Biologji
10. Fizikë
11. Kimi
12. Arsim teknik
13. Informatikë
14. Arsim fizik dhe shëndetësor
15. Arsim figurativ
